



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteti i Bolniçka i Kliniçka Služba Kosova- Hospital and University Clinical Service of Kosovo

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë,

Në mbështetje të Nenit 14 paragrafi 6 nënparagrafi 6.4 i Ligjit nr.04-L 249 për Sigurime Shëndetësore, nenit 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr. 15, 12.09.2011),

Në bazë të Ligjit të Shëndetësisë së Kosovës Nr. 04/L-125, neni 45, paragrafi 1 dhe 2, Nenit 63 paragrafi 2 dhe miraton Statutin e Spitalit të Përgjithshëm në Gjakovë.

STATUTI I SPITALIT TË PËRGJITHSHËM

I DISPOZITAT E PËRGJITHESHME

Neni 1

1. Me këtë Statut rregullohet emërtimi, selia dhe veprimtaria, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e Institucionit, trupat e Institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm profesional, aktet e përgjithshme, pronësia dhe financimi, transparenca, konfidenca afariste dhe profesionale, mbikëqyrja e brendshme dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë të kujdesit shëndetësor në Spitalin e Përgjithshëm “Spitali i Përgjithshëm Gjakovë” (në vazhdim të tekstit Spitali).
2. Themelues i Spitalit është Ministria e Shëndetësisë e Kosovës (në vazhdim të tekstit Ministria).
3. Spitali ka filluar punën në vitin 1945-46 me emrin “Spitali i Përgjithshëm – Gjakovë”

Neni 2

1. Spitali ka statusin e personit juridik publik, me cilësi të autoritetit punëdhënës, ku organizohet, ofrohet dhe zbatohet kujdesi shëndetësor dytësor.

Neni 3

1. Spitali disponon me mjetet dhe pasurinë e cila është pronë e Ministrisë/Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës.
2. Spitali si institucion shëndetësor sekondar është përvetësues i fondeve nga Buxheti i Kosovës dhe burimeve tjera të parapara me Ligjet përkatëse.
3. Spitali u ofron shërbime shëndetësore popullatës së Komunave: Gjakovë, Deçan, Junik, Rahovec, Malishevë, popullata e veriut të Shqipërisë - Malësia e Gjakovës dhe pacientëve të referuar në këtë Spital.

II EMËRTIMI DHE SELIA

Neni 4

1. Emri i Institucionit është “Spitali i Përgjithshëm - Gjakovë”.
2. Shenja njohëse e Spitalit do të aprovohet nga Këshilli Drejtues i Spitalit.
3. Emërtimi i spitalit “ Spitali i Përgjithshëm - Gjakovë” duhet të jetë i mbishkruar në objekt në të cilën kryhet veprimtaria shëndetësore, mësimore dhe shkencore, në gjuhët zyrtare në përdorim në Kosovë.
4. Për ndryshimin e emrit dhe selisë së Spitalit vendos themeluesi.

Neni 5

1. Selia e Spitalit të Përgjithshëm është në: Gjakovë.

Neni 6

Vula e spitalit

1. Vula e Spitalit duhet të jetë në pajtim me Ligjin për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës.
2. Në rrethin e parë të jashtëm të vulës së spitalit shkruhet:
 - 2.1. Republika e Kosovës;
 - 2.2. Emërtimi i spitalit “Spitali i Përgjithshëm- Gjakovë”.
3. Në sipërfaqen e mbetur brenda rrethit më të vogël të vulës vendoset stema e Republikës së Kosovës;
4. Teksti i vulës shkruhet me shkronja të mëdha të shtypit në madhësi dhe formë të njëjtë në gjuhët zyrtare të komunave.
5. Vula është në formën rrethore e cila nuk mund të jetë më e vogël se 20 mm.
6. Vula duhet të përmbajë emërtimin e Institucionit, selinë dhe të jetë në gjuhët zyrtare në përdorim në Kosovë.
7. Spitali posedon vulën rrethore, me dimezime 40 mm, 50 mm dhe 60 mm.
8. Spitali posedon vulën katrore e cila ka dimensionin 35 mm me 70 mm dhe sipas nevojës mund të ketë edhe dimensione tjera.
9. Vula katrore përmban këto të dhëna:
 - 8.1 Stema e Republikës së Kosovës;
 - 8.2 Republika e Kosovës;
 - 8.3 Emërtimi i spitalit “Spitali i Përgjithshëm- Gjakovë”;
 - 8.4 Numri i protokollit me hapësirë për shënimin e numrit të protokollit;
 - 8.5 Numri i faqeve me hapësirë;
 - 8.6 Hapësira ku do të shënohet dita, muaji dhe viti dhe
 - 8.7 Vendi i selisë.
10. Për numrin e vulave, mënyrën e përdorimit dhe autorizimin e personit për përdorim dhe ruajtje vendos Këshilli Drejtues.
11. Çdo vulë ka numër identifikues.

III VEPRIMTARIA E SPITALIT

Neni 7

1. Spitali ofron shërbime shëndetësore sekondare sipas nenit 19 pika 1 të Ligjit për shëndetësi.
2. Në zbatimin e kujdesit shëndetësor, spitali ndërmerri masat e nevojshme për sigurimin e standardeve cilësore dhe sasiore të kujdesit shëndetësor.
3. Spitali ofron shërbime shëndetësore sipas standardeve cilësore të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Nenin 8

1. Lista e shërbimeve që siguron Spitali hartohet nga Këshilli Drejtues me propozim të Këshillit Profesional dhe aprovohet nga Ministria e Shëndetësisë.
2. Spitali siguron dhe zbaton sistemin unik informativ shëndetësor.
3. Repartet e spitalit janë të obliguara të mbajnë dokumentacionin shëndetësor dhe të mbajnë bazën e shënimeve shëndetësore.
4. Spitali do të sigurojë që Repartet e spitalit të implementojnë standardet e cilësisë së shërbimeve të përcaktuara nga Ministria.

IV STATUSI JURIDIK, PËRFAQËSIMI DHE PREZENTIMI

Neni 9

1. Spitali është institucion publik shëndetësor i cili bënë pjesë në Rrjetin e Institucioneve Shëndetësore Publike të Ministrisë.
2. Për nënshkrimin e kontratave me të cilat fitohen, tjetërsohen apo shiten patundshmëritë e Spitalit, Spitali duhet të ketë së pari aprovimin e Ministrisë së Shëndetësisë.
3. Në rast të nënshkrimit të kontratave nga paragrafi 2 Spitali paraqitet si subjekt i pavarur juridik dhe afarist, bazuar në Ligjin për Prokurim Publik dhe Ligjeve të nxjerra nga Ministria e Financave.
4. Për përgjegjësitë e marra financiare Spitali përgjigjet me tërë pasurinë e tij.
5. Qarkullimi i mjeteve financiare bëhet përmes xhirollogarisë unike të Spitalit pranë Ministrisë së Financave të Kosovës.
6. Drejtori i Spitalit ka të gjitha autorizimet për përfaqësim juridik dhe afarist, brenda veprimtarisë së Spitalit, duke marrë parasysh përkufizimet e këtij Statuti.

V ORGANIZIMI I SPITALIT

Neni 10

1. Veprimtaria e Spitalit nga Neni 7 realizohet përmes këtyre Departamenteve:

1.1. Departamenti për Nëna dhe Fëmijë;

1.1.1 Reparti i Obstetrikës (Salla e lindjes),

1.1.2 Reparti i Gjinekologjisë,

1.1.3 Reparti i Pediatriës,

1.1.4 Reparti i Neonatologjisë.

2. Departamenti i degëve Kirurgjike:

2.1 Reparti i Kirurgjisë,

2.1.1 Reparti i Urologjisë,

2.1.2 Reparti i Ortopedisë,

2.1.3 Reparti i Oftalmologjisë,

2.1.4 Reparti i Otorinolaringologjisë .

3. Departamenti i Anestezionit me mjekësi emergjente:

3.1 Shërbimi i Anestezionit:

3.1.1 Shërbimi i Kujdesit Intenziv,

3.1.2 Shërbimet e Emergjencës,

3.1.3 Trakti operativ me dhomën e zgjimit.

4. Departamenti i sëmundjeve të brendshme:

- 4.1 Reparti i Sëmundjeve të brendshme,
 - 4.1.1 Reparti Koronar me Kujdesin Intenziv,
 - 4.1.2 Reparti i Sëmundjeve të Krahërorit,
 - 4.1.3 Reparti i Sëmundjeve të Lëkurës,
 - 4.1.4 Reparti i Sëmundjeve ngjitëse,
 - 4.1.5 Reparti i Hemodializes,
 - 4.1.6 Reparti i Neurologjisë.
5. Departamenti i Psikiatrisë:
 - 5.1 Reparti i Psikiatrisë së përgjithshme,
 - 5.1.1 Reparti i Psikiatrisë së Fëmijëve,
 - 5.1.2 Reparti i Psikiatrisë Forenzike,
 - 5.1.3 Reparti i Sëmundjeve të Varësisë.
6. Departamenti i Diagnostikës:
 - 6.1 Shërbimi i Biokimis
 - 6.2 Shërbimet e Diagnostikimit Radiologjik,
 - 6.3 Shërbimet e Terapisë fizikale,
 - 6.4 Shërbimet për pacientet jashtë spitalor,
 - 6.5 Barnatorja,
 - 6.6 Patologjia me Morgun.
7. Departamenti i administratës dhe shërbimeve të përbashkëta:
 - 7.1 Zyra për Cilësi të Shërbimeve.
 - 7.2 Qendra për Edukim të Vazhdueshëm Profesional;
 - 7.3 Njësi e Personelit;
 - 7.4 Njësia për shërbime juridike;
 - 7.5 Njësia për buxhet dhe financa;
 - 7.6 Njësia për prokurim;
 - 7.7 Shërbimet teknike;
 - 7.8 Sterilizimi qendror
 - 7.9 Lavatorja
 - 7.10 Mirëmbajtja me pastërtinë
 - 7.11 Transporti me autoparkun
 - 7.12 Inseneratori
 - 7.13 Mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore
 - 7.14 IT-Së.
8. Spitali zbaton sistemin unik të informimit shëndetësor ashtu siç është paraqitur me Ligjin e Shëndetësisë dhe aktet nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.

VI UDHEHEQJA DHE TRUPAT E SPITALIT

Neni 11

Këshilli Drejtues

1. Drejtori Ekzekutiv i Spitalit udhëheq me Këshillin Drejtues dhe të gjitha aktivitetet e Spitalit;
2. Në procesin e vendimmarrjes vota e Drejtorit ekzekutiv është votë afirmative.

Neni 12

1. Këshilli Drejtues ka pesë (5) anëtare:
 - 1.1 Drejtori Ekzekutiv i Spitalit kryeson me Këshillin,
 - 1.2 Drejtori Mjekësor i Spitalit,
 - 1.3 Drejtori i Infermierisë,
 - 1.4 Drejtori i Administratës dhe shërbimeve të përbashkëta,
 - 1.5 Përfaqësuesi i Këshillit Profesional.
2. Mandati i anëtarëve të Këshillit zgjatë sa edhe kontrata e tyre. Ky mandat mund të përfundoj edhe më parë në rast:
 - 2.1 Të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në Spital,
 - 2.2 Të dorëheqjes së anëtarit të Këshillit Drejtues,
 - 2.3 Nëse brenda vitit mungon 3 herë pa arsye në mbledhjet e Këshillit,
 - 2.4 Nëse tregon mosrespektim ndaj obligimeve të punës.
3. Anëtarëve të Këshillit Drejtues mund të ju përfundoj mandati edhe në këto raste:
 - 3.1 Nëse nuk ju përmbahet politikave të themeluesit,
 - 3.2 Nëse marrin pjesë në marrjen e vendimeve joligjore ose vendimeve të cilat i shkaktojnë dëm Spitalit.

Neni 13

1. Këshilli Drejtues, me këtë Statut kryen këto punë dhe vendos për:
 - 1.1 Veprimtarinë e Spitalit dhe vërteton politikën punuese të Spitalit,
 - 1.2 Aprovon raportin e punës dhe llogaritë vjetore të Spitalit dhe i raporton SHSKUK-së ,
 - 1.3 Vendos për shfrytëzimin e mjeteve në kuadër të ligjit,
 - 1.4 Programin e punës dhe planin financiar,
 - 1.5 Rregullore për organizimin e punës në Spital dhe akte të tjera në përputhshmëri me Ligjin dhe këtë Statut,
 - 1.6 Sjelljen e planit të burimeve njerëzore sipas propozimit të Këshillit Profesional brenda resurseve të disponueshme dhe në përputhje me politikat e Ministrisë,
 - 1.7 Sjelljen e planit për furnizim të Spitalit dhe vendos për dhënien në shfrytëzim të lokaleve dhe mjeteve, furnizimin dhe dhënien në shfrytëzim të mjeteve të veçanta, pas marrjes së pëlqimit nga SHSKUK-ja,
 - 1.8 Planin mbi Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional të kuadrit medicinal dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor dhe siguron aplikimin e tij,
 - 1.9 Planin dhe programin e masave për mbrojtje në punë,
 - 1.10 Siguron mbarëvajtjen e punëve,
 - 1.11 Emëron Komisione të përkohshme dhe organe tjera punuese,
 - 1.12 Vendos për sigurimin e pasurisë së Spitalit dhe të punëtorëve në bazë të Ligjit,
 - 1.13 Propozon ndërtimin dhe adaptimin e objekteve si dhe për burimet e mjeteve për kryerjen e këtyre punimeve duke u bazuar në politikën shëndetësore,
 - 1.14 Shqyrton raportet periodike mbi punën profesionale,
 - 1.15 Kryen edhe punë të tjera të cilat i janë lënë në kompetencë me këtë statut dhe akte tjera normative të Spitalit.

Neni 14

1. Këshilli Drejtues i Spitalit i kryen detyrat brenda përgjegjësisë së veta në mbledhje.
2. Këshilli Drejtues merr vendim kur janë prezent më tepër se gjysma e anëtarëve.
3. Këshilli Drejtues merr vendim me shumicë të votave të anëtarëve prezent,
4. Në mbledhjen e Këshillit Drejtues mbahet procesverbali të cilin e aprovojnë pjesëmarrësit në mbledhjen vijuese.

5. Këshilli Drejtues aprovon rregullore të punës të Spitalit në të cilën rregullohen më detalisht çështjet në lëmin e punës të cilat nuk janë të rregulluara me Ligj dhe këtë Statut.

Neni 15

Përbërja e Drejtorisë së Spitalit

1. Drejtorinë e Spitalit e përbëjnë:
 - 1.1 Drejtori Ekzekutiv i Spitalit,
 - 1.2 Drejtori Mjekësor,
 - 1.3 Drejtori i Administratës dhe shërbimeve të përbashkëta,
 - 1.4 Drejtori i Infermierisë.

Neni 16

1. Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për afarizëm, prezanton dhe përfaqëson Spitalin dhe është përgjegjës për ligjshmërinë në punë.
2. Drejtori Ekzekutiv udhëheq me punën e Spitalit në bashkëpunim me Këshillin Drejtues, Këshillin Profesional të njësive organizative të nenit 11 të këtij Statuti.

Neni 17

1. Spitalin e udhëheq Drejtori Ekzekutiv i Spitalit.
2. Drejtori Ekzekutiv i Spitalit është punonjës publik.
3. Drejtorin Ekzekutiv të Spitalit e zgjedhë dhe e shkarkon Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së në pajtim me Statutin e SHSKUK-së, dhe dispozitave të parapara me këtë Statut.
4. Drejtori ekzekutiv zgjidhet me konkurs publik në bazë të Ligjit të punës në kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh me mundësi të ri-zgjedhjes edhe një mandat tjetër.
5. Drejtori Ekzekutiv duhet të plotësojë këto kushte:

- 5.1 Doktor i shkencave, magjistër i Mjekësisë apo specialist në njërin nga degët e Mjekësisë,
- 5.2 Doktor i shkencave, magjistër i shkencave juridike, Jurist i Diplomuar,
- 5.3 Doktor i shkencave, magjistër i shkencave ekonomike, Ekonomist i Diplomuar,
- 5.4 Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë në sistemin shëndetësor,
- 5.5 Prej tyre tre (3) në poste udhëheqëse,
- 5.6 Studimet dhe trajnimet në degë të Menaxhmentit shëndetësor dhe Shëndetësisë Publike do të jenë përparësi.

Neni 18

1. Drejtori Shëndetësor:
 - 1.1. Organizon, koordinon dhe udhëheq me punën e shefave të reparteve të Spitalit,
 - 1.2. Propozon planin e punës, planin e kuadrit dhe aftësimin profesional, planin e pushimeve për shefat e reparteve të spitalit,
 - 1.3. I realizon vendimet dhe masat tjera të aprovuara nga ana e Këshillit Drejtues;

Neni 19

1. Drejtori i Administratës dhe shërbimeve të përbashkëta:
 - 1.1 Zhvillimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të politikave dhe procedurave standarde dhe ofrimi i shërbimeve profesionale administrative,

- 1.2 Organizon, koordinon dhe udhëheq me punën e shefave të njësive punuese,
- 1.3 Propozon planin e punës, planin e kuadrit dhe aftësimin profesional, planin e pushimeve për shefave të njësive punuese,
- 1.4 I realizon vendimet dhe masat tjera të aprovuara nga ana e Këshillit Drejtues.

Neni 20

1. Drejtori i Infermierisë:

- 1.1 Organizon, koordinon dhe udhëheq me punën e infermierëve kryesor të reparteve,
- 1.2 Propozon planin e punës, planin e kuadrit dhe aftësimin profesional, planin e pushimeve për infermierët kryesor të reparteve,
- 1.3 I realizon vendimet dhe masat tjera të aprovuara nga ana e Këshillit Drejtues.

Neni 21

1. Vendimin për shpalljen e konkursit për Drejtor Ekzekutiv të Spitalit e merr Bordi Drejtues i SHSKUK-së.
2. Shpalljen e konkursit nga paragrafi 1 i këtij neni e bënë Bordi Drejtues i SHSKUK-së.

Neni 22

1. Drejtori Ekzekutiv i Spitalit është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë në punë dhe afarizmin e Spitalit, si dhe për punën profesionale në Spital e cila duhet të organizohet dhe të udhëhiqet në pajtim me dispozitat e këtij Statuti dhe akteve tjera të përgjithshme ligjore.
2. Drejtori Ekzekutiv i Spitalit është përgjegjës për sigurimin e përkujdesjes efikiente dhe efektive të nivelit të kujdesit dytësor shëndetësor publik me detyra dhe përgjegjësi si vijon:
 - 2.1 Në pajtim me Politikën Shëndetësore dhe Ligjin për Shëndetësi të Kosovës, Drejtori Ekzekutiv i Spitalit i propozon për miratim SHSKUK-së, Planin e Punës dhe Buxhetin e Spitalit për vitin vijues,
 - 2.2 Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për implementimin e planit të burimeve njerëzore sipas nenit 14, paragrafi 1, nen paragrafin 1. 8 i këtij Statuti,
 - 2.3 Të jetë përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në Spital,
 - 2.4 Të zhvillojë marrëdhënie të mira me donatorët dhe OJQ, dhe me partnerët për zbatimin e tyre,
 - 2.5 Të mundësoj zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të Spitalit.
 - 2.6 Të vendos mekanizma të sigurimit të cilësisë në objektet e Spitalit,
 - 2.7 Të jap kontribut për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor të Spitalit sipas standardeve të pranuar dhe të siguroj mbledhjen e informatave,
 - 2.8 Të avancoj punën ekipore,
 - 2.9 Kryen pune të tjera sipas Ligjit dhe akteve të përgjithshme të Spitalit.
3. Programi i punës së Spitalit realizohet duke u bazuar në politikat zhvillimore të sistemit shëndetësor të nxjerrura nga Ministria e Shëndetësisë.
4. Në Programin vjetor të punës duhet të përcaktohen:
 - 4.1 Masat, aktivitetet dhe rezultatet e pritura të kujdesit shëndetësor në Spital,
 - 4.2 Plani vjetor i punës,
 - 4.3 Organizimi dhe udhëheqja,
 - 4.4 Burimet njerëzore,
 - 4.5 Plani financiar,
 - 4.6 Raportet mujore, vjetore të punës dhe raportet financiare.
5. Për kryerjen e punëve të tij, Drejtori i Spitalit i përgjigjet Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së.
6. Procedurën për marrjen e masave administrative ndaj Drejtorit të Spitalit, suspendim apo masa të tjera deri në shkarkim është organi i autorizuar nga SHSKUK-ja, kur konstatohet shkelja e procedurave sipas Ligjit të Shëndetësisë dhe akteve tjera ligjore.

Neni 23

1. Drejtori Ekzekutiv ka për detyrë që gjatë punës dhe vendimeve të Këshillit Drejtues të tërheq vëmendjen:
 - 1.1 Në aktet e propozuara që janë në kundërshtim me ligjet relevante gjegjësisht aktet e përgjithshme të Spitalit,
 - 1.2 Që akti i propozuar është në kundërshtim me programin e punës së Spitalit,
 - 1.3 Që akti i propozuar nuk i kontribuon qëllimit.

Neni 24

Trupat e Spitalit

1. Për përmbushjen e detyrave të veçanta Këshilli Drejtues përmes Drejtorit Ekzekutiv të Spitalit formon Trupa Profesionale këshillë dhënëse pranë Spitalit, siç janë:
 - 1.1. Këshilli Profesional,
 - 1.2. Komisioni disiplinor i Spitalit,
 - 1.3. Komisioni për ankesa i Spitalit,
 - 1.4. Komiteti për Kontroll të Cilësisë,
 - 1.5. Komiteti për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional,
 - 1.6. Komisioni Etiko- Profesional,
 - 1.7. Komisioni për infeksione intrahospitalore,etj.
2. Anëtarët e trupave profesionale emërohen nga Këshilli Drejtues.
3. Këshilli Drejtues përmes Drejtorit Ekzekutiv të Spitalit sipas nevojës mund të formojë edhe trupa të tjera profesionale pranë Spitalit.

Neni 25

Këshilli Profesional

1. Këshilli Profesional është trup këshillë dhënës për Drejtorin e Spitalit.
2. Këshilli Profesional përbëhet nga:
 - 2.1 Shefat e reparteve nga neni 11 i këtij Statuti dhe
 - 2.2 Infermierët kryesor të Reparteve të Spitalit.
3. Kryetarin e Këshillit Profesional e emëron Këshilli Drejtues i Spitalit me Propozim të Këshillit Profesional.\
4. Mandati i Kryetarit të Këshillit Profesional zgjatë dy (2) vite me mundësi të rizgjedhjes për edhe një mandat dy (2) vjeçar.
5. Këshilli Profesional e bënë rregulloren e punës për punën e Këshillit sipas Statutit.

Neni 26

1. Kryetari i Këshillit Profesional kryen këto punë:
 - 1.1 Përgatit, thërret dhe udhëheq mbledhjet e Këshillit Profesional,
 - 1.2 Cakton rendin e ditës së mbledhjes,
 - 1.3 Siguron mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.
2. Kryetari i Këshillit Profesional është i obliguar ta thërras mbledhjen brenda tre (3) ditëve pasi të ketë kërkuar Drejtori Ekzekutiv ose Drejtori Mjekësor.

Neni 27

1. Këshilli Profesional i Spitalit përveç detyrave të parapara me Ligj i kryen edhe këto detyra:

- 1.1 Diskuton dhe vendos për nevojën dhe arsyet profesionale të implementimit të metodave dhe procedurave të reja diagnostikuese dhe terapeutike.
- 1.2 Propozon Këshillit Drejtues dhe Drejtorit Ekzekutiv marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë.
- 1.3 Propozon strukturë mbikëqyrëse të brendshme lidhur me punën e punëtorëve shëndetësor si dhe masat për përmirësimin e punës profesionale.
- 1.4 Shqyrton nevojën për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe i propozon Këshillit Drejtues dërgimin e punëtorëve shëndetësor në edukim profesional dhe ngritje shkencore.
- 1.5 Shqyrton dhe vendos lidhur me çështjet tjera të cilat Drejtori ia parashtron Këshillit Profesional.

Neni 28

Këshilli Etik Profesional

1. Këshilli Etik Profesional është trup i cili siguron kryerjen e veprimtarisë së Spitalit mbi bazat e etikës dhe deontologjisë.
2. Anëtarët e Këshillit Etik Profesional i emëron Këshilli Drejtues.
 - 2.1 Këshill etik përbëhet nga tre (3) anëtarë:
 - 2.1.1 Një (1) anëtar i Këshillit Profesional,
 - 2.1.2 Një (1) anëtar i cili është nga Shoqëria Civile, ose nga Shoqata e pacientëve ose nga KMDLNJ,
 - 2.1.3 Një (1) anëtar profesionist shëndetësor,
 - 2.1.4 Një (1) anëtar në pajtim me KKS (monitorues).
3. Përbërja e Këshillit Etiko Profesional duhet të respektojë barazinë gjinore dhe nacionale.

Neni 29

1. Këshilli Etik Profesional i Spitalit i kryen këto punë:
 - 1.1 Përcjellë implementimin e veprimtarive etike dhe deontologjike në lëmin e shëndetësisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Spitalit,
 - 1.2 Miraton kërkime shkencore në Spital sipas dispozitave Ligjore që rregullojnë këtë lëmi,
 - 1.3 Shqyrton çështje të tjera etike lidhur me veprimtarinë e Spitalit.
2. Këshilli etik Profesional përgatit rregulloren e punës së Këshillit etik Profesional.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e trupave përcaktohen me akte nënligjore të nxjerra nga Këshilli Drejtues, përmes Drejtorit Ekzekutiv të Spitalit, nëse ato nuk janë të përcaktuara me akte të tjera nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 30

Organizimi Sindikal

1. Në Spital mund të veprojnë organizata sindikale, ku punëtorët me anëtarësimin e tyre vullnetar do t'i realizojnë të drejtat dhe interesat e veta të garantuara me Ligjin mbi organizmin sindikal, KKS-në dhe konventat ndërkombëtare të punës.
2. Në rast të grevë së punëtorëve, në Spital duhet të sigurohet minimumi i kryerjes së detyrave të punës apo shërbimeve në pajtim me Ligjet në fuqi.
3. Përfaqësuesve të FSSHK u sigurohet pjesëmarrja në mbledhjet e organeve drejtuese ekzekutive të Spitalit në cilësinë e vëzhguesit, pa të drejtë vote.

VII EDUKIMI I VAZHDUESHEM PROFESIONAL

Neni 31

1. Në kuadër të Spitalit funksionojnë Qendrat për EVP në të cilat organizohet Edukimi i Vazhdueshëm Profesional për të gjithë punëtorët shëndetësor, bazuar në dispozitat e Ligjit për shëndetësi dhe akteve të tjera nën ligjore që rregullojnë këtë lëmi.
2. Financimi i EVP bëhet nga buxheti i Spitalit dhe burim tjera të disponoheshe.

IX AKTET E PERGJITHESHME

Neni 32

1. Aktet e përgjithshme të Spitalit janë: Statuti, Rregulloret e punës dhe vendimet përmes të cilave rregullohen çështjet nga veprimtaria e Institucionit.

Neni 33

1. Me propozim të Drejtorit Ekzekutiv, Këshilli Drejtues nxjerr këto akte të përgjithshme të Spitalit:

- 1.1 Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës,
- 1.2 Rregulloren për punë,
- 1.3 Rregulloren për gradim, pagesa dhe të drejta tjera materiale të punëtorëve nëse me akte tjera nuk është rregulluar ndryshe;
- 1.4 Rregulloren për mbrojtje në punë,
- 1.5 Rregulloren për mbrojtje kundër zjarrit,
- 1.6 Rregulloren për kontabilitetin e brendshëm,
- 1.7 Rregulloren për rendin shtëpiak,
- 1.8 Rregulloren për parandalimin e infeksioneve,
- 1.9 Rregulloren për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale,
- 1.10 Rregulloren për ankesa,
- 1.11 Rregulloren për udhëtime zyrtare dhe komisione,
- 1.12 Rregulloret tjera për mbarëvajtjen e punës në Spital.

X PRONESIA, BUXHETI DHE FINANCAT

Neni 34

Pronësia

1. Pasuritë e Spitalit e përbëjnë të drejtat dhe të mirat materiale, të cilat kanë qenë të evidentuara si pronë shoqërore me të cilat Spitali ka pasur të drejtë të disponojë në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës.
2. Po ashtu pasurinë e Spitalit e përbëjnë të drejtat dhe të mirat materiale, të cilat pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës, Spitali i ka fituar me punë ose nga të hyrat e tjera.

Neni 35

Buxheti

1. Çështjet buxhetore dhe financiare të Spitalit administrohen në mënyrë transparente në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave publike si dhe me të gjitha procedurat, si dhe në përputhje me udhëzuesit e Ministrisë së Financave.
2. Buxheti dhe llogaritë e Spitalit duhet të përfshijnë tërë shpenzimet operative të njësive punuese.
3. Prokurimi nga Spitali bëhet konform rregullave të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Spitali ia prezanton buxhetin vjetor SHSKUK-së për miratim.
5. Drejtori Ekzekutiv mund të kërkoj Auditim-Revizion të jashtëm që të monitoroj shfrytëzimin e drejtë të mjeteve.

Neni 36

Financimi

1. Spitali i shfrytëzon burimet financiare konform Ligjit për Shëndetësi të Kosovës, nga Buxheti i Kosovës dhe burime të tjera të parapara me Ligjet përkatëse.
2. Bashkë pagesa për shërbimet e ofruara në Spital, si burim i financimit të aktiviteteve të Spitalit, do të bëhet në bazë të cmimores së aprovuar nga Ministria(SHSKUK).
3. Spitali do të nxjerrë akte të veçanta nënligjore të detajizuara për llojin dhe shumën e pagesave të ndryshme që do të jetë në pajtim me udhëzimet përkatëse të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë.

XI TRANSPARENCA NË PUNË

Neni 37

Struktura, kushtet dhe mënyra e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në kuadër të veprimtarisë së Spitalit janë publike dhe transparente ndaj personave juridik, fizik, në pajtim me Ligjet në fuqi.

Neni 38

Informatat dhe të dhënat mbi veprimtarinë si dhe shikimi në dokumentacionin mbi veprimtarinë shëndetësore, personave të autorizuar apo mjeteve të informimit mund të iu jep vetëm Drejtori Ekzekutiv ose punëtori i Spitalit të cilin ai e autorizon.

XII KONFIDENCA PROFESIONALE

Neni 39

1. Zbulimi i sekretit afarist konsiderohet dhënia e dokumentacionit dhe të dhënave të tjera në shikim të personave të paautorizuar, veprim i cili do të shkaktoje dëm reputacionit dhe interesit afarist të Spitalit si dhe në pajtim me Ligjin.
2. Dokumentet të cilat vlerësohen sekret afarist i përcakton Këshilli Drejtues me akt të veçantë bazuar në ligjet në fuqi.
3. Mos ruajtja e sekretit afarist konsiderohet si shkelje e rëndë e detyrave të punës.
4. Për ruajtjen e sekretit afarist drejtpërsëdrejti kujdeset Drejtori Ekzekutiv.

XIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 40

Aktet e përgjithshme të parapara me këtë Statut duhet të nxjerrin në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij Statuti.

Neni 41

Hyrja në fuqi

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Statuti përfundon fuqia e akteve tjera që rregullojnë punën e Spitalit, e që janë në kundërshtim me këtë Statut.

Neni 42

Ky Statut hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.
Prishtinë, **07.04.2016**

Dr. Imet Rrahmani
Ministër i Shëndetësisë
